

V E N D I M

“PËR VENDOSJE SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARI: ASTRIT FAQOLLI

Me sekretare **NAJADA MUSTAFA**, në Tiranë me datën **08.05.2015**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen penale Nr. **668** që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me prokurore seance **Sonila Muhametaj**.

OBJEKTI: Vendosjen e sekuestro preventive, duke urdhëruar sekuestrimin e llogarive bankare të shtetasit Italian M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht Raiffaisen, Procredit, BKT me balancat si më poshtë: Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....0101 762 EUR, pranë **Raiffeisen Bank, për shumën 411.835.78 EURO**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....7000 2 EUR, pranë **ProCredit Bank, në shumën 356.643.25 Euro**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....6834, pranë **Bankës Kombëtare Tregtare, në shumën 438.032.71 Euro**.

KUNDËR: **M. G. A. P.**, i biri i F., i datëlindjes 21.12.19.., i identifikuar me pasaportë YA.....657, me adresë Nr.2 ,Milano, Itali.

IDYSHUAR: Për veprën penale të **“Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”**, parashikuar nga Neni 287 i K. Penal.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në prani të prokurores e cila kërkoi: “Vendosjen e sekuestro preventive, duke urdhëruar sekuestrimin e llogarive bankare të shtetasit Italian M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri”.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën dhe u njoh me provat e administruara në seancë gjyqësore lidhur me çështjen penale Nr. datë 07.05.2015.

V Ë R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur për shqyrtim kërkesën për Vendosjen e sekuestro preventive, duke urdhëruar sekuestrimin e llogarive bankare të shtetasit Italian M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht Raiffaisen, Procredit, BKT, pasi dyshohet se ka kryer veprën penale të *“Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”*, parashikuar nga Neni 287 i K. Penal.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes rezulton se, më datë 07.05.2015 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penale Nr...., për veprën penale të *“Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”* parashikuar nga Neni 287 i K. Penal, në ngarkim të shtetasit Italian M. G. A. P..

Ky procedim është regjistruar pasi Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka konstatuar se shtetasi Italian M. G. A. P. ka transferuar shumën 1. 500. 000 Euro nga llogaria bankare në Zvicër (CH.....2001) drejt tre bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht për secilën bankë, Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Procredit, shumën 500.000 Euro, si dhe ka tërhequr prej tyre në këto banka shumën në total 337.762 Euro.

Meqënëse ka pasur dyshime për burimin e fondeve dhe origjinën e tyre Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka lëshuar urdhërin drejtuar bankave të nivelit të dytë, për bllokimin e përkohshëm të transaksioneve të shtetasit Italian M. G. A. P..

Ka rezultuar se shtetasi Italian M. G. A. P. ka hyrje – dalje të shpeshta në Shqipëri, kryesisht gjatë vitit 2015 ku edhe ka hapur llogari bankare në bankat e nivelit të dytë të përmendura më lart dhe më pas ka bërë dhe transfertat bankare nga banka e Zvicrës për shumën 1.500.000 Euro në të tre këto banka. Sipas shpjegimeve të dhëna nga bankat këto shuma shtetasi Italian M. G. A. P. i ka transferuar për të blerë shtëpi, për përdorime personale dhe për hapjen e një biznesi në Shqipëri. Kjo transfertë është bërë pasi në bankën urdhëruese nuk e lejonin të bënte tërheqje në cash, por vetëm transfertë dhe se burimi i këtyre shumave është nga puna e tij si muzikant dhe se familja e tij ka një studio muzikore në Itali.

Gjithashtu ka rezultuar se shtetasi Italian M. G. A. P., nëpërmjet kontratës së huasë të datës 09.03.2015 i ka marrë hua shtetasit shqiptar F. T. shumën prej 11.600 Euro. Nga verifikimet

rezulton se ky shtetas nuk figuron me këtë emër në rregjistrin e gjëndjes civile të vitit 2008, por është i pajisur me pasaportë dhe se ka patur emrin T. T..

Për sa më sipër duke qenë se pasuritë e shumta dyshohet se janë produkte të veprave penale ose veprimtarisë kriminale, si dhe ka rrezik që disponimi i lirë i tyre mund të rëndojë pasojat e veprës penale për të cilën është rregjistruar ky procedim penal, duke u tjetërsuar ose transferuar, gjykata çmon se duhet të vendoset sekuestro preventive duke urdhëuar sekuestrimin e llogarive bankare në emër të shtetasit Italian M. G. A. P. në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri të përmendura më lart.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata mbështetur në Nenin 274 të K. Pr. Penale

V E N D O S I

1. Vendosjen e sekuestros preventive për një afat 2 mujor mbi llogaritë bankare të shtetasit Italian **M. G. A. P.**, në bankat e Nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht: Në Nr.Llogarie (IBAN) AL7.....0101 762 EUR, pranë **Raiffeisen Bank për shumën 411.835.78 EURO**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....7000 2 EUR pranë **ProCredit Bank, në shumën 356.643.25 Euro**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL2.....6834 pranë **Bankës Kombëtare Tregtare, në shumën 438.032.71 Euro**, pasi dyshohet për veprën penale **“Pastrimt të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”**, parashikuar nga Neni 287 i K.Penal.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brënda 10 ditëve.
3. U shpall sot më datë **08.05.2015** në Tiranë.

SEKRETARE

NAJADA MUSTAFA

GJYQTAR

ASTRIT FAQOLLI